Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË CEREMONINË E DIPLOMIMIT TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

14 nëntor 2012

President Nishani,
Drejtore Semini,
Autoritete te shquara,
Të dashur të diplomuar,
Zonja dhe zoterinj.

Mirëdita!

Është kënaqësi e madhe për mua të jem këtu me ju, sot, në këtë ceremoni që mbledh profesionin më të lartë ligjor të vendit.

Si kryetar i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, gjithashtu, është nder për mua të marr pjesë në këtë panel vërtet të shquar folësish.

Duke iu bashkuar fjalimeve të mëparshme, lejomëni t'ju uroj për përfundimin e studimeve në Shkollën e Magjistraturës. Jam i sigurt që ka qenë një sipërmarrje sfiduese, që ka kërkuar përpjekje të mëdha.

Një nga përgjegjësitë e Prezencës së OSBE-së, sipas mandatit tonë, është dhënia e ndihmës dhe ekspertizës autoriteteve shqiptare në fushën e reformës gjyqësore.

Kjo na ka mundësuar të punojmë së bashku me Shkollën e Magjistraturës përgjatë viteve, për çështje të ndryshme, në disa raste. Për shembull, kemi bashkëpunuar ngushtësisht me Shkollën në ofrimin e trajnimeve profesionale për Shërbimin e ri të Provës dhe në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në këtë pikë, kam kënaqësinë t'ju informoj për një veprimtari të suksesshme që patëm dje me mbështetjen e madhe të Ministrit të Drejtësisë Halimi, i pranishëm këtu, të mbështetur gjithashtu edhe nga Ministri i Brendshëm, z. Noka.

Ky bashkëpunim ka qenë gjithmonë një përvojë shpërblyese.

Shkolla e Magjistraturës është një institucion kyç për të ardhmen e gjyqësorit. Ne besojmë fort se një arsimim ligjor i cilësisë së lartë ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e punës së gjyqësorit.

E them me gëzim që të diplomuarit e Shkollës e kanë përligjur këtë besim ndër vite. Tani e keni ju në duar, brezi i 2012-s që të vijoni këtë prirje pozitive të rëndësishme.

Prej një kohe të gjatë, ne e kemi ndihmuar Shkollën në procedurën e monitorimit të provimeve të pranimit dhe është shumë inkurajuese të shohësh një garë aq të fortë për një

numër të kufizuar vendesh. Fakti që një numër aq i madh studentësh të drejtësisë shfaqin interes të mirëfilltë për të studiuar në Shkollën e Magjistraturës dëshmon cilësinë e institucionit tuaj.

Kjo gjë siguron edhe që vetëm juristët më të mirë të këtij vendi të pranohen në Shkollë.

Të dashur të diplomuar, nuk është nevoja t'ju kujtoj rëndësinë e respektimit të të drejtave të njeriut, si pjesë e themeleve të një shoqërie demokratike.

Përgjatë viteve, ju jeni trajnuar më së miri në legjislacionin për të drejtat e njeriut. Por këto të drejta nuk zbatohen vetëm në çështjet ligjore të koklavitura në Gjykatën Kushtetuese dhe në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Shumë instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut janë mishëruar në legjislacionin vendas, duke u dhënë këtyre rregullave përparësi ndaj ligjeve të tjera.

Në thelb, ato nuk janë çështje teorike, por çështje praktike që prekin jetën dhe të ardhmen e qytetarëve të kësaj shoqërie, përfshirë jetën tuaj personale dhe atë të pjesëtarëve të familjes suaj.

Zbatimi i të drejtave të njeriut në punën tuaj si gjyqtarë e prokurorë është një detyrë sipërore.

Ai është një kontribut praktik në përmirësimin e gjendjes së të drejtave të njeriut në vendin tuaj dhe në fuqizimin e shtetit të së drejtës.

Ju, të diplomuarit, ndodheni tani në prag të të bërit pjesë e sistemit gjyqësor, në një nivel akoma më të lartë. Kjo është një përgjegjësi e madhe. Unë jam i bindur që ju jeni përgatitur më së miri për të. Dhe kjo është një detyrë e fisme.

Lejomëni t'ju uroj sërish dhe t'ju uroj gjithë të mirat në punën tuaj të ardhshme dhe në karrierën tuaj ende të re.

Paçi fat!

Fund